



E nderuar Dr. Kondaj,
Në përfundim të mandatit tuaj, dëshiroj të përsëris vlerësimin institucional për përkushtimin dhe kontributin energjik në drejtimin e SHBSHK-së.
Me rolin tuaj personal dhe të ekipit drejtues, bëtë, padyshim, të mundur konsolidimin e profilit të SHBSHK në rrezatimin e vlerave mbarëshqiptare në provincën e Ontarios, forcimit të miqësisë mes komuniteteve dhe ndërveprimit dinamik me Shqipërinë, Kosovën dhe botën shqiptare të kudondodhur.

I uroj, njëkohësisht, suksese Kryetares së re, znj. Aida Lumi-Bejte dhe gjithë ekipit drejtues në punën fisnike të çuarjes përpara të veprimtarisë së SHBSHK-së për ruajtjen e identitetit kombëtar, thellimit të projekteve social-kulturore që, duke vënë në qendër dinamikën e komunitetit shqiptar të të gjitha trevave, jo vetëm lartësojnë emrin e Shqipërisë dhe të kombit shqiptar në Kanadanë mikpritëse, por edhe ndikojnë në forcimin e marrëdhënieve mes dy popujve dhe vendeve tona.

Do të ishte një kënaqësi e veçantë të ndaja me ju festimin e 7 Vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, por si pasojë e disa angazhimeve në Otavë nuk do të jetë e mundur të marr pjesë në këtë organizim. Me këtë rast, kam ngarkuar Konsullin e Nderit, Genc Tirana, të jetë i pranishëm.
Mbetem thellësisht e angazhuar në bashkëpunimin me SHBSHK, me dëshirën për t'ju vizituar në Toronto në një kohë tëvolitshme.

Gëzuar nga zemra Pavarësinë e Kosovës!

Elida Petoshati
Ambassador of the Republic of Albania